



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr. 7, datë 14/06/2022

PËR

**MIRATIMIN “KËRKESË PËR TRANSFERIM TË  
LEJES/AUTORIZIMIT”, NGA SUBJEKTI “DRITAN ÇITOZI”  
PERSON FIZIK TE SUBJEKTI “FATJON KAMBERRI” PERSON  
FIZIK**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e transferimit të lejes Nr.2369/10, datë 03.10.2019 miratuar nga ish KBU Ishëm-Erzen (aktualisht burimi ujor i përket KBU Ishëm) me Vendim Nr.16 datë 20.09.2019, për përdorim burimi ujor nëntokësor (pus-shpim) për qëllime teknologjike (lavazh), nga subjekti “Dritan Çitozi” person fizik me NIPT K41530019H te subjekti “Fatjon Kamberri” person fizik me NIPT M01314042A, me vendndodhje në Shkozë, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

Pus-Shpimi (Koordinatat e pusit në KRRGJSH)

- X=487818.17
- Y=4577757.83
- Z=148 m.m.n.d

Prurja mesatare : 0,001 m<sup>3</sup>/s

Sasia e ujit në përdorim : 0,0003 m<sup>3</sup>/s

Qëllimi i përdorimit : Ujë teknologjik për lavazh

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Rrjeti i kanalizimeve UK Tiranë

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

